

LIKA: SERBIA DHE KOSOVA NË FUND TË DIALOGUT NJOHJE RECIPROKE

Intervistë me ligjëruesin në Departamentin e Shkencave Politike të Universitetit të Liezhit në Belgjikë, Liridon Lika Kosova Info: Në këto tetë vite pavarësi, si e shihni shtetin e Kosovës...



by [Kosova Info](#)

8 Apr 2016

Intervistë me ligjëruesin në Departamentin e Shkencave Politike të Universitetit të Liezhit në Belgjikë, Liridon Lika

Kosova Info: Në këto tetë vite pavarësi, si e shihni shtetin e Kosovës ?

LIKA: Që nga 17 shkurti i vitit 2008, Republika Kosovës e ka konsoliduar në mënyrë të konsiderueshme, nga viti në vit, statusin e saj si shtet i pavarur, demokratik dhe sovran. Republika Kosovës i plotëson të gjitha kriteret që përcaktojnë cilësinë e një shteti të shënuara në Konventën e Montevideos të vitit 1933, siç janë popullsia e pérhershme, territori i përcaktuar, qeveria, si dhe kapaciteti për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera. Për më tepër, Republika Kosovës është njohur zyrtarisht nga 111 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Kjo tregon që pavarësia e saj do të jetë e pérhershme.

Kosova Info: Sa të rëndësishme janë njohjet zyrtare për një shtet të ri ?

LIKA: Njohja ndërkombëtare e një shteti të ri nga shtetet ekzistuese ka një rëndësi të madhe për të ardhmen, qëndrueshmërinë, sovranitetin dhe pranimin e tij në organizata të ndryshme ndërkombëtare qofshin ato të karakterit politik, ekonomik, të sigurisë apo edhe atij sportiv. Njohja zyrtare është një vendim politik i cdo shteti ekzistues, por në të njëjtën kohë përforcen sovranitetin e shtetit të ri. Në të drejtën ndërkombëtare nëse një shtet i ri njihet zyrtarisht nga shtetet ekzistuese atëherë njohja është e pérhershme. Thënë ndryshe, njohjet zyrtare nuk mund të zhbëhen. Pra, në praktikën e përgjithshme vendimi për njohjen zyrtare të një shteti tjetër nuk mund të tërhiqet, dhe në këtë mënyrë nuk ka kthim prapa në këtë proces.

Kosova Info: Siç e thatë, deri më tani Republika Kosovës është njohur zyrtarisht nga 111 shtete anëtare të OKB-së. Si e komenton çështjen e njohjeve të shtetit të Kosovës?

LIKA: Me 111 njohje zyrtare në tetë vite pavarësi, Republika Kosovës e ka konsoliduar fuqishëm pozitën e saj si shtet i pavarur dhe sovran në skenën ndërkombëtare. Njohjet zyrtare të Republikës së Kosovës mund të quhen apo konsiderohen kualitative ose cilësore së paku për tri arsy. Së pari, shtetet më të fuqishme, më të pasura dhe më demokratike të botës e kanë njohur tashmë shtetin e ri dhe vazhdojnë që ta mbështesin edhe më tutje drejt anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Këto shtete të cilat përbëjnë kryesisht botën perëndimore, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe fuqitë e mëdha evropiane, janë shumë të pranishme në Kosovë me të cilën kanë lidhur marrëdhënie të ngushta dypalëshe apo shumëpalëshe.

Së dyti, tri ndër katër vendet fqinjë të drejtpërdrejt të shtetit të Kosovës e kanë njohur zyrtarisht atë dhe bashkëpunojnë aktivisht në të gjitha fushat. Procesi i demarkacionit fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë si dhe asaj të Maqedonisë tashmë ka përfunduar, ndërsa ai me Malin e Zi është ende në proces të diskutimit në Kosovë. Për më tepër, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia kanë hapur tashmë ambasadat e tyre në Prishtinë dhe anaçelltas. Prandaj, Republika Kosovës e ka zënë kështu vendin e duhur në rajon ku respektohet si shtet i pavarur dhe sovran. Me fjalë të tjera, njohja zyrtare e shtetit të Kosovës nga këto tri vende ka krijuar tashmë stabilitet dhe paqe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Së terti, shumica e shteteve të kontinentit evropian e kanë njohur zyrtarisht Republikën e Kosovës. Në mesin e tyre 23 nga 28 janë shtete anëtare të Bashkimit evropian (BE) dhe 34 nga 47 janë anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo është tepër me rëndësi për vet faktin që Kosova gjeografikisht është pjesë e Evropës. Njohja nga këto shtete do të thotë shumë për arsy se pse ato njojin më mirë situatën apo gjendjen reale në Republikën e Kosovës sesa shtetet nga kontinentet e largëta të cilat nuk kanë ndoshta aq shumë informacione për vendin tonë. Por gjithashtu, njohja nga shumica e shteteve evropiane ka bërë që Kosova të anëtarësohet në shumë organizata rajonale dhe të lidhë marrëdhënie kontraktuale me BE-në përmes MSA-së me qëllim të anëtarësimit në projektin e përbashkët evropian. Kështu që, pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe e patjetërsueshme. Prandaj, njohja e këtij realiteti nga të gjitha shtetet e botës do të kontribuonte edhe më tepër në drejtim të paqes dhe ripajtimit rajonal dhe do të forconte edhe më tepër sovranitetin e jashtëm të Republikës së Kosovës.

Kosova Info: Sa është i rëndësishëm sovraniteti për një shtet ?

LIKA: Ushtrimi i sovranitetit të plotë është me rëndësi shumë të madhe për secilin shtet. Për shembull, autori Raymond Carré de Malberg theksion se sovraniteti është natyra më e lartë apo supreme e pushtetit. Supreme sepse pushteti shtetëror nuk pranon asnjë tjetër fuqi, as mbi të, as në konkurrencë me të. Që nga viti 1648, pas Traktatit të Vestfalise që i dha fund luftës tridhjetëvjeçare, sovraniteti, i brendshëm dhe i jashtëm, i shtetit bëhet një parim themelor në marrëdhënet ndërkombëtare. Sovraniteti i brendshëm dhe i jashtëm janë dy koncepte të ndryshme, por formojnë një tërësi të pandashme. Sovraniteti nënkupton epërsi të pushtetit brenda territorit shtetëror në raport me të gjithë qytetarët e tij dhe pavarësi të plotë nga jashtë. Pra, shteti është zot brenda territorit të tij sepse siç thotë një autor tjetër, Max Weber, ai mban monopolin e dhunës legjitime fizike. Për sa i përket sovranitetit të jashtëm, shteti ka gjithashtu një pushtet absolut në kuptimin që nuk njeh asnjë kufizim ose nënshtrim ndaj një shteti tjetër apo një fuqie të jashtme.

Kosova Info: T'i rikthehem i rastit të Kosovës. Sa e ka përforcuar Republika Kosovës sovranitetin e saj të brendshëm ?

Lika: Në aspektin e sovranitetit të brendshëm ka pasur përparime të theksuara. Siç dihet minoriteti serb, i mbështetur dhe i manipuluar nga shteti fqinjë Serbia, ka bërë përpjekje të vazhdueshme që nga shpallja e pavarësisë që të sfidojë shtrirjen e sovranitetit të Republikës së Kosovës në veri të vendit. Mirëpo, nëse e analizojmë rrjedhën e procesit sipas një këndvështrimi të gjatë kohor, pra nga viti 2008 e deri më sot, shteti i Kosovës e ka forcuar dukshëm praninë dhe kontrollin e tij në të gjithë territorin e vendit duke përfshirë këtu edhe komunat veriore. Duhet përmendur fakti që minoriteti serb në Kosovë përbënë vetëm 4 % të popullsisë së përgjithshme, ku pjesa më e madhe e tij jeton në jug të vendit dhe është e integruar prej disa viteve në institucionet e Republikës së Kosovës me anë të zgjedhjeve të lira të organizuara nga shteti kosovar. Në nëntor të vitit 2013, për herë të parë, zgjedhjet komunale u zhvilluan edhe në veri të vendit nën kornizën kushtetuese të Republikës së Kosovës në komunat e banuara me shumicë nga minoriteti serb. Për

më tepër, gjithnjë e më shumë serbë të Republikës së Kosovës janë të pajisur me letërnjoftime dhe pasaporta të lëshuara nga autoritetet e shtetit kosovar.

Sipas institucioneve kosovare 483 anëtarët e strukturave paralele dhe të paligjshme serbe të financuara nga Serbia fqinjë kanë rënë dakord për t'i dhënë fund aktiviteteve të tyre kriminale në veri të vendit dhe të integrohen në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, duke nënshkruar kontratat e punës me qeverinë kosovare. Kështu që, procesi i shpërbërjes së strukturave paralele serbe dhe integrimi gradual i minoritetit serb të veriut të vendit nën rendin kushtetues të Republikës së Kosovës kanë forcuar gradualisht sovranitetin e brendshëm shtetëror. Me fjalë të tjera, këta shembuj tregojnë se shtrirja e sovranitetit të brendshëm të shtetit të Kosovës në gjithë territorin e tij ka njohur një fuqizim të mirë krahasuar me vitin 2008. Megjithatë, ka mbetur ende punë për t'u bërë nga institucionet e Republikës së Kosovës, mirëpo edhe pse ngadalë, jam i bindur se gjérat janë duke lëvizur në mënyrë të sigurt drejt stabilizimit të plotë të veriut të vendit.

Është me rëndësi të nënvizohet që ndarje të territorit të Republikës së Kosovës nuk mund të ketë. Në të vërtetë, të gjitha shtetet që kanë dalë nga shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë kanë ruajtur kufijtë e tyre të jashtëm të përcaktuar në Kushtetutën federale jugosllave të vitit 1974. Kjo është bërë për shkak se ka qenë zbatuar parimi i quajtur uti possidetis (që do të thotë ashtu siç e ke poseduar në të kaluarën, do të vazhdosh të posedosh edhe në të ardhmen). Duke u nisur nga ky parim, ndarja eventuale e territorit të Republikës së Kosovës as që ka mundur të vije në shprehje. Shteti i Kosovës do të ruaj kufijtë e tij të cilët janë të njohur ndërkombëtarisht, të përcaktuar në planin e Ahtisaarit, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe në flamurin shtetëror.

Pra, ashtu sikurse Republikat e tjera të dala nga shkatërrimi i ish-Jugosllavisë, edhe Republika Kosovës ka trashëguar të njëjtë kufijtë që i kishte nga viti 1974 e deri më 1988, që do të thotë ata të para marrjes së paligjshme dhe të dhunshme të autonomisë së Kosovës nga regjimi shtypës i Sllobodan Milosheviqit.

Kosova Info: Po për sa i përket sovranitetit të jashtëm të shtetit të Kosovës ?

LIKA: Sovraniteti i jashtëm ka njohur gjithashtu një fuqizim që është për t'u vlerësuar. Siç e thash, deri më tanë, shteti i Kosovës është njohur zyrtarisht nga 111 nga 193 shtete anëtare të OKB-së. Është me rëndësi të theksohet se edhe shumë shtete të tjera të botës të cilat ende nuk na kanë njohur zyrtarisht nuk e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, por thjesht ende nuk e kanë marrë vendimin e tyre zyrtar të njohjes edhe pse në praktikë i njohin pasaportat e lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, përvëç 111 njohjeve zyrtare, edhe njohja e pasaportës së Republikës së Kosovës paraqet një njohje të realitetit. Në të vërtetë, pasaporta e Republikës së Kosovës është njohur nga përafërsisht 150 vende, duke përfshirë këtu Greqinë, Sllovaninë dhe Rumaninë. Kjo do të thotë se shumë vende të botës, duke përfshirë edhe këto tri shtete anëtare të BE-së e njohin realitetin e ri të krijuar më 17 shkurt 2008.

Për më tepër, mendimi këshillëdhënës i 22 korrikut të vitit 2010 i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) ka konfirmuar në mënyrë të qartë se shpallja e pavarësisë së Kosovës është në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Ky është një pohim i rëndësishëm ndërkombëtar në dobi të shtetit të Kosovës.

Republika Kosovës ka ratifikuar gjithashtu një numër të madh të marrëveshje ndërkombëtare dhe është bërë anëtare e disa organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Vetëm vendet apo shtetet e pavarura mund të bëhen anëtarë të këtyre institucioneve.

Prandaj, pavarësisht pengesave të shkaktuara nga armiqëtë e Republikës së Kosovës, Serbia dhe aleati historik i saj Rusia, megjithatë shteti ynë ka bërë përparim të rëndësishëm edhe sa i përket fuqizimit të sovranitetit të jashtëm të tij.

Kosova Info: Si e analizoni politikën armiqësore të Rúsisë ndaj Pavarësisë së Kosovës ?

LIKA: Siç dihet Rusia është aleati historik i Serbisë dhe penguesi kryesor i njohjeve të reja zyrtare dhe i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në OKB. Politika e jashtme e Rúsisë në raport me Ballkanin nuk është diçka e panjohur për Shqiptarët si popull në përgjithësi. Rusia edhe në vitin 1912 ishte përpjekur me ngulm të pengonte lindjen e Shqipërisë si shtet i pavarur dhe sovran. Shqiptarët nuk janë popull sllav dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me këta të fundit as në aspektin etnik, as në atë kulturor dhe as në atë gjuhësor. Shqiptarët janë popull autokton në Ballkan. Ata janë pasardhës të drejtpërdrejt të llirëve që banonin historikisht dhe në mënyrë të përhershme tërë pjesën qendrore dhe

perëndimore të Ballkanit dhe një pjesë të territorit të Italisë Jugore shumë kohë para invazioneve sllave. Popujt sllavë kanë filluar të vendosen në Ballkan rreth shekujve VI, VII e deri në shekullin e X të erës sonë. Këto invazione sllave bënë që trojet e të parëve tanë, pra llirëve, të rrudhen ndjeshëm.

Më vonë, gjatë gjithë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, në emër të pansllavizmit, Rusia ka mbështetur fuqishëm popujt sllavë të Ballkanit, në mënyrë të veçantë Serbët dhe Malazezët. Rusia mundohej të shtrinte ndikimin e saj hegemonist në tërë rajonin e Ballkanit dhe të kishte dalje në detin Mesdhe. Ajo dëshironte që të gjitha territorët e Ballkanit të cilat ishin nën sundimin e Perandorisë osmane dhe një pjesë e territoreve austro-hungareze t'u jepeshin shteteve të apo lindura sllave të rajonit. Mirëpo një gjë të tillë e penguan deri diku Perandoria austro-hungareze dhe Italia të cilat ndiheshin të kërcënua nga zgjerimi i shteteve sllave në Ballkan, përmes të cilave Rusia synonte t'i realizonte qëllimet e saj hegemoniste. Në këtë periudhë Rusia pati ndikim kyç që shteti i ri shqiptar i shpallur më 28 nëntor 1912 në Vlorë të copëtohej padrejtësish dhe që Kosova dhe territorët e tjera të banuara kryesisht me popullsi shqiptare t'i jepeshin Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë në konferencën e ambasadorëve të mbajtur në Londër më 1913. Prandaj, edhe në ditët tona politika e jashtme ruse në raport me Republikën e Kosovës, e banuar me 93 % shqiptarë autoktonë, njeh një vazhdimësi. Rusia mbetet ende një aleat i fuqishëm i Serbisë dhe për këtë arsy po kundërshton anëtarësimin e Republikës së Kosovës në OKB.

Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se më 17 shkurt 2008, Kosova ka shpallur pavarësinë e saj duke u bazuar plotësisht në propozimin e ndërmjetësuesit të OKB-së Martti Ahtisaari, i cili pas një procesi të gjatë të negociatave ndërmjet Shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë pati rekomanduar më 2007 që Kosova duhet të jetë një shtet i pavarur dhe sovran. Ky proces negociator dhe vet ndërmjetësuesi i OKB-së, përvèç mbështetjes së SHBA-ve, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë, Italisë, kishte edhe mbështetjen e Rusisë. Plani i Ahtisaarit ishte pranuar nga Shqiptarët e Kosovës dhe nga vendet perëndimore, ndërsa ishte refuzuar nga Serbia. Mirëpo pasi që Serbia nuk e pranoi planin e Ahtisaarit, atëherë Rusia, ashtu siç ka bërë të njëjtën gjë historikisht, doli menjëherë në mbështetje të kësaj të fundit dhe kërcënoi me përdorim vote miratimin e tij në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Megjithatë, Shqiptarët e Kosovës të mbështetur fuqishëm nga shtetet perëndimore me në krye SHBA-të dhe fuqitë e mëdha evropiane vendosën të shpallin pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008, duke u bërë thirrje të gjitha shtetëve të botës që ta njohin shtetin e ri. Prandaj, pavarësia e Kosovës është shpallur në koordinim të plotë me shumë shtete të botës, veçanërisht ato të botës perëndimore. Përpjekjet e gjata dhe të mundimshme të Shqiptarëve për pavarësinë e Kosovës u arritën me ndihmën e fuqive perëndimore të cilat mbështetën fuqimisht krijimin e shtetit kosovar, që faktikisht është shteti i dytë shqiptar, dhe korrigjuan kështu një padrejtësi historike të bërë ndaj popullit shqiptar në konferencën e ambasadorëve në Londër më 1913.

Kosova Info: Sa kanë arritur Serbia dhe Rusia t'i pengojnë njohjet zyrtare të Republikës së Kosovës nga shtetet e tjera të botës ?

LIKA: Serbia dhe Rusia jo vetëm që po refuzojnë njohjen zyrtare të Republikës së Kosovës, por dhe po bëjnë presion të vazhdueshëm te shtetet tek të cilat kanë ndikim që të mos e njohin zyrtarisht shtetin e ri evropian. Për shembull, për shkak të presionit të Serbisë mbi Bosnjë-Hercegovinën, kjo e fundit ende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Shumica e popullsisë së këtij vendi, pra kroatët dhe bosnjakët, janë të gatshëm ta bëjnë menjëherë një gjë të tillë, mirëpo duke pasur parasysh karakterin federal të Bosnjë-Hercegovinës, serbët e këtij shteti të shtyrë nga Serbia po refuzojnë të marrin një vendim zyrtar për të njohur Republikën e Kosovës. Në anën tjetër, Rusia po bënë presion të vazhdueshëm tek të gjitha shtetet nën ndikimin e saj që të mos e njohin shtetin e Kosovës. Nën presionin e saj të vazhdueshëm janë ish-shtetet e Bashkimit sovjetik veçanërisht ato të Azisë qendrore të cilat në parim nuk janë kundër pavarësisë së Kosovës. Presioni rus vërehet edhe tek disa shtete të tjera të botës, qofshin ato të Afrikës apo të Amerikës latine, me të cilat Rusia ka marrëdhënie të mira.

Në fakt, pas mendimit të GJND-së, e cila tregoi qartë që pavarësia e Kosovës është plotësisht konform të drejtës ndërkombëtare, as Serbia, as Rusia, por as shtetet e tjera të botës nuk kanë më arsyë ligjore që të mos e njohin shtetin e Kosovës. Mirëpo, për shkak të lidhjeve të ngushta historike, fetare, kulturore, interesave gjeostrategjike dhe dëshirës hegemoniste të Rusisë në Ballkan të cilat synon t'i realizoj përmes bashkëpunimit me Serbinë, ashtu siç ka bërë historikisht në mënyrë të vazhdueshme, shteti rus vazhdon ende të përkrah Beogradin në qëndrimet e tij armiqësore ndaj shtetit të Kosovës. Përvèç Serbisë dhe deri diku të Bosnjë-Hercegovinës për shkak të refuzimit të një pjesë të serbëve të këtij vendi, të gjitha shtetet e tjera të rajonit janë bërë tashmë anëtare të NATO-s, janë në proces të

anëtarësimit, ose kanë shprehur qartazi dëshirën për anëtarësim të plotë duke përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës. Pra, vendi i vetëm në Ballkan përmes të cilit Rusia mundohet të mbajë sadopak ndikimin e vet hegemonist në këtë rajon mbetet ende Serbia.

Sidoqoftë, Republika Kosovës e ka konsoliduar fuqishëm shtetësinë e saj në këto tetë vite të pavarësisë. Me gjithë pengesat serbe dhe ruse, procesi i njohjeve zyrtare po vazhdon dhe Republika Kosovës po bëhet gradualisht, por në mënyrë të sigurt, pjesë e skenës ndërkontaktore si shtet i pavarur dhe sovran. Këtë e dëshmon, siç e thash edhe më parë, edhe anëtarësimi i saj në shumë institucione dhe organizata ndërkontaktore në të cilat vetëm shtetet e pavarura mund të jenë pjesë e tyre.

Kosova Info: A do ta njoh zyrtarisht Serbia shtetin e Kosovës ?

LIKA: Serbia, si vend kandidat, nuk mund të hyjë në BE pa i normalizuar plotësisht marrëdhëniet me shtetin e saj fqinjë, Republikën e Kosovës. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira me vendet fqinjë janë kushtet thelbësore të cilat duhet të plotësoj secili shtet kandidat që dëshiron të anëtarësohet në BE. Prandaj, normalizimi i marrëdhënieve nënkuption që Serbia nuk duhet dhe nuk do të mund t'i bëjë asnjë pengesë në të ardhmen anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkontaktore përfshirë këtu edhe OKB-në. Pra, dialogu që po zhvillohet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në Bruksel ka për qëllim të normalizoj marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve fqinjë në aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të qytetarëve të të dy vendeve. Thënë ndryshtë, dialogu po zhvillohet ndërmjet përfaqësuesve të dy shteteve të pavarura dhe të barabarta. Qëllimi përfundimtar i tij është njohja zyrtare reciproke ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Duhet theksuar që opinioni publik në Serbi ka ndryshuar dukshëm kohët e fundit duke u pajtuar me realitetin që Republika Kosovës është tashmë shtet i pavarur. Edhe autoritetet zyrtare serbe janë plotësisht të vetëdijshme që pavarësia e Kosovës është punë e kryer që nga viti 1999 kur Kosova u vendos nën protektorat ndërkontaktor, dhe sidomos pas vitit 2008 kur ajo shpalli pavarësinë e saj e cila është njohur tashmë nga shumica e shteteve anëtare të OKB-së dhe është konfirmuar nga GJND-ja. Prandaj, njohja zyrtare nga ana e Serbisë do të merr ndoshta ende kohë, mirëpo ajo është një çështje e domosdoshme të cilës Serbia nuk do të mund t'i ikë në vitet në vazhdim, veçanërisht në momentin kur Beograd do të jetë i gatshëm të anëtarësohet në BE.

Kosova Info: Si mund t'i përshkruani marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit evropian ?

LIKA: Nga institucionet evropiane, Parlamenti evropian ka njohur tashmë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Parlamenti evropian është shumë i zëshëm në mbështetje të njohjeve të reja të Republikës së Kosovës. Që nga viti 2008 deputetët evropianë kanë miratuar 5 rezoluta të cilat u bëjnë thirrje të gjitha shteteve anëtare të BE-së që ta njohin zyrtarisht shtetin e Kosovës.

Për më tepër, Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe Parlamenti evropian kanë ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së. MSA-ja e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill të këtij viti është marrëveshja e parë kontraktuale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së. Kjo ngjarje është pa dyshim një konfirmim i fuqishëm i sovranitetit të Republikës së Kosovës, sepse kjo lloj marrëveshje nënshkruhet dhe ratifikohet vetëm midis BE-së dhe shteteve të pavarura të kontinentit evropian, më saktësisht të atyre të Ballkanit Perëndimor, të cilat dëshirojnë të bëhen anëtare të projektit evropian. Kështu që, shteti i Kosovës është i aftë të udhëheq në mënyrë aktive në emër të vet marrëdhëniet ndërkontaktore me vende të botës dhe brenda organizatave dhe institucioneve ndërkontaktore. Kjo tregon që Republika Kosovës është shtet i pavarur dhe sovran.

Shtetet e mëdha të BE-së të tillë si Gjermania, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Austria janë mbështetës të fuqishëm të Republikës së Kosovës. Këto shtete kanë përsëritur rregullisht se Serbia nuk mund të hyjë në BE pa e njohur zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Ruga e vetme e Republikës së Kosovës por edhe e shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor është ajo që çon drejt anëtarësimit të plotë në NATO dhe në BE. Që nga viti 2014, me Procesin e Berlinit, perspektiva evropiane e vendave të rajonit është bërë edhe më e qartë. BE-ja po bënë përpjekje që të përgatis vendet e Ballkanit Perëndimor për t'u anëtarësuar sa më shpejt në projektin e përbashkët evropian. Me ndërmjetësimin e BE-së është bërë e mundur që viteve të fundit në Beograd të shkojnë ministrat e Republikës së Kosovës, dhe në Prishtinë të vijnë ata të Republikës së Serbisë. Kjo i ka dhënë një shtytje edhe më të madhe normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Në të gjitha

këto takime kryeministrat dhe ministrat kosovarë dhe serbë janë të barabartë dhe përfaqësojnë shtetet e tyre përkatëse. Edhe termi i takimeve Western Balkans 6 që përfshinë të 6 shtetet e rajonit (Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi) e tregon qartazi që Brukseli e konsideron Kosovën si një shtet të barabartë me vendet e tjera të rajonit.

Intervistoi: Myrvete FEKA, Liezh (Belgikë)

Liridon Lika, i lindur më 1985 në Drenas, është asistent/ligjërues dhe kandidat për doktoraturë në Qendrën për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit të Liezhit në Belgikë. Hulumtimet e tij fokusohen në çështjet që kanë të bëjnë me vendet e Ballkanit Perëndimor, veprimin e jashtëm të Bashkimit evropian dhe politikën e jashtme turke në raport me shtetet e Ballkanit Perëndimor

CATEGORIES **INTERVISTA** **TOPLAJM**



OLDER ARTICLE

SIRI: KRYENGRTËSIT E MODERUAR E MARRIN NJË QYTET NGA IS-I

by Kosova Info - Apr 8, 2016

NEXT ARTICLE

THAÇI SOT INAUGUROHET PRESIDENT I KOSOVËS (DIREKT)

by Kosova Info - Apr 8, 2016

NO COMMENT

LEAVE A REPLY

NAME *

EMAIL *

WEBSITE

POST COMMENT

Reklama e vogël: 1 DITË = 1 €

■ TE FUNDIT NGA SPORTI

13 APR 2016 Presidenti i Naurusë uron Presidentin Thaçë


12 APR 2016 Hecking thotë se Reali e meritoi kualifikimin

12 APR 2016 Zidane krenar me Realin, lavdëron Ronaldon

12 APR 2016 "Prishtina" fiton Kampionatën e VIII të Kosovës në Taekwondo në...

12 APR 2016 Ronaldo çon Realin në gjysmëfinale

RELATED BY



INTERVISTA

Gashi: LDK të hyjë në partneritet me parti më të vogla, jo më me PDK-në

"LDK-ja tashmë është në fazën ku nuk duhet të ketë vija të kuqe për askënd", thotë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, deputeti i Lidhjes Demokratike të...



EKONOMI

Mustafa: Përkushtimi i qeverisë solli rritjen ekonomike

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se përkushtimi i plotë i qeverisë së tij për të pasur në fokus zhvillimin ekonomik, ka dhënë dhe do të vazhdojë të...



OPINIONE

Për Evropën, 2015-a viti më vdekjeprurës nga terrorizmi

"REL" Terrorizmi u bë më i frikshëm e më i afërt për Evropën, kur militantë të grupit Shteti Islamik lanë të vrarë 130 njerëz nëntorin e vitit 2015 në Paris. Në...



LAJME

KIPRED: FSK-ja dhe Policia e Kosovës më të besueshmet

Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës kanë dalë të jenë më të besueshmet nga qytetarët e Kosovës. Ndërsa, Agjencja Kosovare e Inteligencës ka dalë të jetë...



LAJME SPORT EKONOMI KULTURË INTERVISTA OPINIONE SHKENCE LIFESTYLE SHOWBIZ TECH



COPYRIGHT 2016 KOSOVA.INFO DIZAJNI: EKIPISUKSESIT